



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FUSHE-ARREZ
KESHILLI

Nr. 3121 prot.

Fushe-Arrez, me 25.10 2023

Lenda : Relacion mbi projektvendimet nr.21.date 23.10.2023 dhe 22, date 23.10.2023 qe do t' i paraqiten Keshilli te Bashkise per shqyrtim ne mbledhjen e dates 30.10.2023.

Ne zbatim te ligjit 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", i ndryshuar . Rregullores per Funkcionimin e Keshillit te Bashkise. duke marre ne konsiderate faktin qe kete vit kemi pasur zgjedhje vendore me 14.05.2023, nisur nga perberja e Keshillit te ri Bashkiak Fushe-Arrez. ka lindur nevoja e ringritjes se dy komisioneve keshillimor , atij qe lidhet me shqyrtimin e propozimeve per akordimin e titujve vendor te nderit dhe komisionit per shqyrtimin e propozimeve per akordimin e statusit te " Deshmorit te Atdheut."

Keshtu per projektvendimin nr.21.date 23.10.2023 "Per ngritjen e Komitetit Keshillimor per shqyrtimin e propozimeve per akordimin e titullit "Qytetar Nderi" , pervec majtes ne konsiderate te realitetit te ri ne Keshillin e ri te Bashkise dhe burimet intelektuale qe zoteron komuniteti vendas., te gjitha keto ne pajtim me ligjin 112/2013"Per dekorat, titujt e nderit dhe medaljet dhe titujt vendor te nderit." dhe VKB nr. 860,date.10.02.2014"Per miratimin e rregullave te hollleshme per funksionimin e komisioneve keshillimore per dhenjen e titujve vendor te nderit"

Njekohesisht per te ndihmuar keshilltaret ,por edhe individe dhe subjekti eshte pergatitur nje udhezim mbi procedurat e paraqitjes se propozimeve per titujt e nderit

Per projektvendimin nr.22. date 23.12.2023"Per ngritjen e komisionit keshillimor per shqyrtimin e propozimeve per akordimin e statusit "Dedhmor i Atdheut" eshte mbajtue parasysh jo vetem realiteti ekzistues ne Keshillin aktual, por eshe fakti qe nje pjese e anetareve te ketij komisioni ose e kane pasur te veshtire te ndjekin procesin, ose jane larguar me vendbanim.. ose kane neglizhuar ne kryerjenn e ketij angazhumi, faktore keta qe kane sjelle edhe rishikimin e perberjes se ketij komisioni ne funksion te permiresimit te punes se tij.

E gjitha kjo ne funksion te mirefunksionimit te tij.

Ftoj keshilltaret qe me mendimet e propozimet e tyre te kontribuojne si ne perberjen ashtu dhe te punes se tij.

Duke kerkuar bshkepunimin tuaj.

SEKRETARI

Tom CURRI



KRYETARI

Nikolin BARDHOKU

